

FINANCA NDËRKOMBËTARE

TREGU I VALUTAVE

“Kur spanjollët erdhën në Indinë Perëndimore, ata kishin nevojë për mjaft mallra, të cilët menduan t’i blejnë tek vendasit duke iu ofruar atyre para – monedha ari. Indianët i morrën paratë, i futën në gojë duke i kafshuar, por ia pështynë mbrapsht spanjollëve duke u dhënë të kuptonin se ata as mund t’i hanin dhe as mund t’i përdornin këto para, prandaj nuk do t’i shkëmbejnë mallrat e tyre për to, por vetëm nëse spanjollët do të kishin mallra të tjerë që mund t’u shërbenin atyre”

Eduard Leight (1671)

Pse Tregu i këmbimit valutor?

- Rritja e vëllimit të transaksioneve ndërkombëtare;
- Rritja e eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve;

Si rezultat:

- Shkëmbimi i flukseve vjetore të kapitalit;
- Nevoja e shitjes dhe blerjes të valutave të huaja.

TREGU I VALUTAVE

- Lehtëson tregtinë dhe investimet nga një vend në tjetrin.

1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

Qëllimi:

- Transferimi i fuqisë blerëse të një valute në një tjetër – tregtim i një valute me një tjetër.
- Psh:
- E pa përshtatshme që blerësit dhe shitësit individual të valutave t'a kërkojnë njëri tjetrin?
- Vëllimi shumë i madh i transaksioneve.

1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

- Tregu i këmbimit valutor – tregu ndërbankar,
- Nuk konceptohet si një vend i përcaktuar fizikisht;
- Përfaqëson një rrjet bankash dhe agjentësht të valutës së huaj me funksion të bashkojnë blerësit dhe shitësit e valutës së huaj;
- Nuk është i kufizuar brenda një shteti;
- I hapur në të gjitha qendrat financiare më të mëdha të botës


1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

- Tregu i këmbimit valutor – *foreign exchange*
- Përfytyroni ?

- Tregu i këmbimit valutor me pakicë – *dealers*
- Klientët:
 - Korporatat
 - Invstitorët institucional
 - Menaxherët e parave

1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

Skema 1.1. Struktura e tregut të valutave



1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

- Tregtimi bëhet nëpërmjet telefonit, kompjuterit etj.
- Konfirmimi formal i transaksionit bëhet më vonë
- TKV punon 24 orë sepse qendrat e mëdha finciare janë të shpërndara gjeografikisht në mbarë botën
- Kur është mesnatë në Londër, në tregjet e Paqësorit dhe Aziatik është mëngjes.
- Aktiviteti i parë i tregut është në Sidnej dhe Wellington
- Shpejt pasohet në Tokio dhe Osaka, Hong Kong dhe Singapor
- Një rënje e papritor ndodh në ora 1 – dreka në ato tregje
- Intensiteti rritet pas dite, kur Singapori e H.Kongu mbyllen, ndërsa Frankfurti e Londra hapen.

1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

- Qendra tjera në Evropë janë: Cyrihu, Kopenhaga dhe Parisi.
- Intensiteti i tregtis rritet kur hapet Nju Jorku dhe përputhet me aktivitetin evropjan;
- Tregtia bie pas mbylljes së Nju-Jorkut, deri kur tregjet e Azisë Lindore hapen përsëri.

1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

Qka i karakterizon këto tregje?

- Transaksionet ndërbankare janë në shuma të mëdha (secili mbi 1 milion)
- Qasja e investitorëve me pakicë dhe bizneseve të vogla është e kufizuar,
- Ato tregtojnë me banka afariste (shpesh me kuota më pak të favorshme) se sa në tregun ndërbankar

1.1 ORGANIZIMI I TREGUT TË KËMBIMIT VALUTOR

Qka i karakterizon këto tregje?

- Investitorët e vegjël marrin pjesë në këto tregje përmes ndërmjetësve , të cilët mundë të krijojnë urdhëresa në tregjet derivative të ardhshme (futures) dhe opsioneve.
- Kohëve të fundit, trendi i rritjes së shpejtë të tregtisë elektronike në tregun ndërbankar dhe në atë të shitjes me pakicë.

MADHËSIA E TREGUT

- TKV është më i madh në botë (i matur sipas vëllimit të tregtisë së dollarit amerikan)
- Në vitin 1973 vëllimi ditor ishte 10-20 miliardë \$
- Në fund të vitit 1980 ishte 500 miliardë \$
- Shtator 1993 ishte 1 trilion \$
- Në viti 2004 ishte 2 trilion \$
- Në vitin 2010 ishte 3,9 trilion \$
- Këto 3,9 trilion përfshijnë të gjitha tregjet dhe të gjitha valutat nv mbarë botën, jo vetëm tregtinë e realizuar në Nju-Jork

MADHËSIA E TREGUT

Çka ka ndiku në rritjen e këtij vëllimi?

- Padyshim – procesi i globalizimit
 - Qoi në rritjen e tregtisë ndërkufitare të mallrave;
 - Shërbimeve dhe
 - Letrave me vlerë (kërkojnë transaksione në tregun *forex*)
- Aktivitete spekulativ, tregtia me vëllim dhe frekuenc të lartë e fondeve investuese, poashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

LLOJET E KONTRATAVE TË TREGTUARA

Në TKV bëhen lloje të ndryshme të tregtimeve.

Ja disa:

- Tregu i çastit (spot) – këmbimi i menjihershëm i parave
- Tregu swap – këmbimi i valutave në të ardhmen
- Letra me vlerë derivative – kontratat e ardhshme dhe opsionet e valutave të huaja

SHITËBLERSIT E VALUTAVE

Pjesëmarrësit kryesor në tregun e valutave janë:

- Bankat afariste,
- Bankat e investimeve, dhe
- Firmat e ndërmjetësimit.

Ata funksionijnë si shitblerës të valutave. Kështu krijojnë treg.

I japin likuiditet tregut, duke bërë më të lehtë dhe me kosto më të ulët takimin e blerësit dhe shitësit.

Kur janë në numër të madh (bl.e shit) tregjet janë shumë likuide dhe kostot e transaksionit janë tv ulëta.

NDËRMJETËSIT E VALUTAVE

- Kanë rrolin e ndërmjetësit financiar,
- Marrin tarifë ndërmjetësimi,
- Kanë shumë linja komunikimi të hapura, andaj
- Japin informacione shitblerësve të valutave për çmime më të mira në dispozicion,
- Shitëblerësit i përdorin ndërmjetësit edhe për ta ruajtur anonimitetin e tyre
- Ofruesi i këtyre shërbimeve elektronike (EBS) – Thomson Reuters – filloi sistemin e parë anonim elektronik
- Në EBS – tregtohen €-\$ dhe \$-jen
- Në Reuters – tregtohen £-\$

TREGTIA ELEKTRONIKE E VALUTAVE

- Mbulon mbi 50% të tregjeve të qastit

Avantazhet e saj janë:

- Mundëson tregtin e një Fondi pensional me një fond investues (bankat e humbin funksionin e drejtuesit të tregut)
- Tregtia është krejtësisht anonime
- Siguron transparencë të çmimeve (çmimi i tregut duket në platformë elektronike nga të gjithë)
- Ofron mundësinë e drejt përmes përpunimit të mandatit bankar, ku një transaksion financiar kompletohet pa ndërhyrje manuale STP (Straigh-through-processing)

TREGTIA ELEKTRONIKE E VALUTAVE

- Tregtia e këmbimit të valutave fillon me dhënjen e urdhëresës deri në shlyerje të transaksionit, evidentimin automatik në sistemin kontabël, pa gabime si pasojë e dokumentacionit me gabim.
- Tregtia elektronike ka përmirësuar dukshëm likuiditetin e tregut valutor dhe ka zvogëluar shpenzimet e tregtimit.

TREGTIA ELEKTRONIKE E VALUTAVE

Ekzistojnë tri kategori të ndryshme të “eFX”

1) Platrfoma “portale” e sponsorizuar nga një bankë e vetme

Psh: platforma “Autobahn” e Deutsche Bank

2) Platforma FXConnect nga State Street, e lëshuar në vitin 1996
– operonte fillimisht me tregtar institucional, e më vonë edhe me tjerë (tregti ndërbankare)

3) Portali Fxall në maj 2001 – operon me klientë korporativ

Ka edhe portale tjera, të tilla si:

a) Hot spot, dhe

b) Currenx.

LISTIMET DHE ÇMIMET E VALUTAVE

Mbi 150 vende të botës kanë valutat e tyre.

Tregtia e valutave drejtohet nga një grumbull i konventave dhe praktikave të ndërlikuara.

Ja disa koncepte:

KURSI I KËMBIMIT

Është çmimi relativ i dy parave, sikurse çmimi i jenit i shprehur në dollar amerikan.

- Palët përdorin shkurtesa të valutave
- Paraqitet nevoja për standardizimin e shkurtesave
- Shkurtesat I parashtrojnë Organizata Ndërkombëtare e Standradizimit – ISO (grek.*isos*=barazi)

Psh:

Simboli për lekun = ALL; denari = MKD; dollarin amerikan+USD

Në raste tjera përdoren simbolet e zakonshme:

£; \$, €

LISTIMI IKURSIT TË KËMBIMIT

Meqenëse KK janë çmime relative, ato shprehen në dy mënyra:

- 1) Me terma direkt – si çmimi i valutës së huaj i shprehur në valutën vendëse; dhe
- 2) Me terma indirekt- si çmimi i valutës vendore i shprehur në valutë të huaj

- Sa kushton ajo makinë?
- Sa kushtojnë 1000 euro?
- 0,90/£
- $1,000 \text{ €} \times (0,90\text{£}/\text{€}) = 900 \text{ £}$

LISTIMI IKURSIT TË KËMBIMIT

Kurset e këmbimit zakonisht listohen duke u bazuar në konventat e tregut të valutave.

Për valutat bazë - kryesore, ndjekin këtë rradhitje:

- Euro
- Sterlina britanike
- Dollar australian
- Dollar neozelandez
- Dollar amerikan
- Dollar kanadez
- Frang zvicerane, dhe
- Jeni japonez

LISTIMI IKURSIT TË KËMBIMIT

Psh:

Supozojmë se nevojitet 100 JPY për të blerë 1 dollar. Kursi i këmbimit i shprehur indirekt nga pikpamja amerikane është:

$$1/(100\text{¥}/\$) = 1\$/100\text{¥} = 0,01\$/\text{¥}$$

Tani supozojmë se jemi në SHBA dhe dëshirojmë të udhëtojmë në Japoni. Nëse ju nevojiten 500.000 jen për udhëtim, është e natyrshme të pyesni: “Sa dollarë nevojiten për të blerë 500.000 jen”? Meqenëse KK zakonisht listohet si 100¥/\$, kostoja në \$ e 500.000¥ është:

$$500.000\text{¥}/(100\text{¥}/\$) = 5.000 \$$$

LISTIMI IKURSIT TË KËMBIMIT

Listim evropian – sasia e valutave të huaja e nvojshme për të blerë dollarë

Listim amerikan – çmimi në dollar I një valute të huaj.

Listimi Direkt dhe Indirekt		
	SHBA	BRITANI
\$ për £	Direkt	Indirekt
\$ për £	Amerikan	Amerikan
£ për \$	Indirekt	Direkt
£ për \$	Evropian	Evropian
	Në RM	Në BE
Denarë për €	Direkt	Indirekt

Valutat motorike dhe kurset e tërthorta të valutave

Dollari amerikan është valutë ,motorike, sepse është përdorur në mënyrë aktive në shumë transaksion financiare ndërkombëtare në mbarë botën.

Listimet e dollarit me 3 korrik 2012		
VALUTA	Në USD	Për USD
Dollari australian	1.02648	0.97420
Sterlina britanike	1.56838	0.63760
Dollari kanadez	0.98592	1.01428
Juani kinez	0.15752	6.34850
Korona daneze	0.16926	5.90810
Euro	1.26180	0.79260

Valutat motorike dhe kurset e tërthorta të valutave

- **Dollari amerikan** është valutë ,motorike, sepse është përdorur në mënyrë aktive në shumë transaksion financiare ndërkombëtare në mbarë botën.
- Në shekullin XIX valuta kryesore motorike ishte sterlina.
- Tani është dollari amerikan
- Tregtarët bëjnë tregti direkt në një ose dy valuta të rëndësishme.

Valutat motorike dhe kurset e tërthorta të valutave

- Kurset ekëmbimit midis dy valutave që nuk përfshijnë dollarin quhen ***kurse të tërthorta***.

Kodet	Sterlin	D.kandez	Euro	Jeni	F.Zvicera	D.amerik	Leku
GBP	1	0.6268	0.8049	0.008009	0.67	0.6379	0.005946
CAD	1.5961	1	1.2846	0.012782	1.0693	1.018	0.009488
EUR	1.2426	0.7788	1	0.009951	0.8325	0.7926	0.007387
JPY	124.895	78.2733	100.514	1	83.6681	79.6619	0.7425
CHF	1.493	0.9357	1.2015	0.011956	1	0.9523	0.008876
USD	1.5678	0.9826	1.2618	0.012555	1.0503	1	0.00932
ALL	174.421	109.309	140.373	1.3968	116.846	111.248	1

Arbitrazhi trekëndor

- Është proces që mban kurset e tërthorta (euro për sterlina) në përputhje me kurset e këmbimit të listuara në raport me dollarin.
- Një tregtar blen sterlina me euro, i shet sterlinat në dollar, mandej dollarët për euro.
- Nëse në fund ka më shumë euro se në fillim, ai ka fitim.
- Ai pra krijon fitim arbitrazhi – të pastër pa risk.

Psh: Suozojmë se çmimi i sterlinës në euro është: 1,1555€/£

Supozojmë se ky kurs është më i ulët se kursi indirekt, duke përdorur dollarin si valutë të ndërmjetme.

$$(\text{Euro/Sterlina}) < (\text{Euro/Dollar}) \times (\text{Dollar/Sterlin})$$

Arbitrazhi trekëndor

- Kurset e këmbimit vijues të euros në krahasim me sterlinën dhe dollarin dhe dollarin krahasuar me sterlinën janë:

EUR 1,1555/GBP ose GBP 0,86543/EUR

EUR 0,76388/USD ose USD 1,3091/EUR

USD 1,5386/GBP ose GBP 0,64994/USD

Përcaktoni fitimin e arbitrazhit, kur Agimi fillon me 10.000.000 € dhe blen GBP.

Shih grafikonin!

JKU 1.7. Diagram aljabar dari nilai tukar



TREGU NDËRBANKAR

Një tregtar i valutave është përgjegjës për blejen dhe shitjen e një valute të caktuar ose grup valutash, dhe mban stoqe – protfolio të pozicioneve në këto valuta.

Pse tregu ndërbankar?

Për të përshtatur portfoliot e tyre sipas transaksioneve që paraqiten nga klientët e tyre në tregun e korporatave.

Psh:

“TREGTIA E PATATES SË NXEHTË”

DIFERENCIALET OFERTË - KËRKESË

Tregtarët në tregun ndërbankar përpiqen që të shesin dhe blejnë valuta të ndryshme me qëllim që të krijojnë fitim.

Për ta bërë këtë ata listojnë çmimet e dyanshme.

- Kursi i ofertës – është veprimi sipas të cilit ata duan të blejnë valutën bazë (b)
- Kursi i kërkesës – është veprimi sipas të cilit ata shesin valutën bazë (s)
- Çmimi i ofertës është gjithmonë më i vogël se i kërkesës

Shembull 1.3.